

Cikli I programeve: “PERMES BIBLES”

Emisioni nr 1072 Zbulesa 1

Ndërsa fillojmë librin e Zbulesës jam paksa i hutuar. Në të vërtetë jam pak i frikësuar, ndërkohë që mbërrim në një nga librat më të mëdhenj në Fjalën e Zotit. Por, sinqerisht, dua t'ju them se jam shumë i gëzuar që do të fillojmë këtë studim. Më lejoni të shpjegojem.

E kam pasur zakon, që sa herë kisha nevojë për një kohë shlodhjeje, lexoja një histori të mistershme, një histori me detektivë policie. Më duhet të pohoj se historitë e mistershme kanë qenë për vite të tëra pak a shumë si një hobi për mua.

Sot nuk lexoj më, shumë libra të Agata Kristit për arsye të thjeshtë se kam lexuar aq shumë libra të saj sa që mund ta kuptoj fare lehtë se kush është vrasësi. Tani kam filluar të lexoj librat e Dorëti Seiërs. Ajo është e krishterë dhe fut shumë pjesë nga Shkrimi në librat e saj. Të pashpëtuarit po e lexojnë Biblën pa e kuptuar. Gjithsesi, gjithmonë më kanë pëlqyer historitë e mistershme.

Kur fillova shërbesën, isha beqar dhe cdo të dielë në mbrëmje pas shërbesës së darkës, shtrihesha në shtrat dhe lexoja një nga ato histori misterioze.

Një herë, rreth orës 1 të mëngjesit, kisha arritur në vendin ku personazhi kryesor, që ishte grua, ndodhej e lidhur në binarin hekurudhor nga të këqinjët dhe për njëzet minuta në atë vend do të kalonte treni me numër 77. E gjora ndodhej në një situatë të dëshpëruar. Mendova se heroi do të ishte në gjendje ta shpëtonte para se të kalonte treni, por duke lexuar mora vesh se ai ndodhej në një magazinë të vjetër, i lidhur tek një karrige, nën të cilën ndodhet një sasi dinamiti i sapo ndezur! Epo, të them të drejtën nuk mund ta lija heroin dhe heroinën në atë gjendje në orën një të mëngjesit. Por, meqënëse më kishte kaluar ora e gjumit, shfletova disa faqe dhe mbërrita në faqen e fundit. Para meje u shpalos një skenë krejt tjetër. Pashë heroin dhe heroinën të ulur në një kopsht me lule. Pashë edhe një shtëpi të këndshme të rrethuar nga një gardh i bardhë. Tani ata janë martuar dhe kanë një bebe të vogël që luan në lëndinë. C'skenë e mrekullueshme dhe ngushëlluese!

Kështu u ktheva sërish mbrapa tek vendi ku ndërpreva leximin dhe i thashë heroit dhe heroinës: “Nuk e di se si do të dilni nga ajo situatë, por po ju them që gjithcka do të shkojë shumë mirë.”

Të dashur miq, në Bibël gjendet një libër që quhet libri i Zbulesës i cili më tregon se si do të përfundojë kjo skenë botërore. Të them të drejtën, shqetësohem pak kur shoh gjërat që ndodhin sot në botë. Unë shoh një pamje të errët sot në botë, dhe pyes veten se si do t’i vejë filli vallë? Epo, më lejoni t’ju them se mjafton të shkoj në librin e fundit të Biblës dhe kur filloj të lexoj se c’thuhet aty e kuptoj se gjërat do të shkojnë shumë mirë. A e dini këtë? Emersoni ka thënë se *gjërat* i kanë hipur në qafë njerëzimit. Dhe duket pikërisht kështu. Në fakt, duket sikur djalli po kalon pushime të këndshme në botë, por Zoti do t’i rregullojë gjërat. Vetë Perëndia do të marrë kontroll. Në fakt Ai nuk e ka humbur asnjëherë kontrollin dhe do të vendosë mbi fronin e këtij universi, Birin e Tij, Zotin Jezus Krisht. Sot gjithcka duket e errët. Cdo person që sheh situatën e botës sot me një sy optimist, e ka gabim. Bota ndodhet në një situatë të dëshpëruar. Gjithsesi, unë nuk jam pesimist sepse kam librin e Zbulesës dhe mund t’i them cdo personi që i beson Krishtit: “Mos u mërzit. Cdo gjë do të shkojë më së miri.” Miqtë e mi, një ditë Zoti do të jetë në majë. Prandaj, dua të jem me Të. Kalvini ka thënë: “Do të preferoja më mirë të humbisja tani dhe të fitoja më vonë sesa të fitoja tani dhe të humbisja më vonë.” Dua t’ju them se tani jam në anën që duket sikur po humbet, por ne do të fitojmë më vonë. Arësyeja nga e di këtë është sepse kam lexuar librin e Zbulesës. Dhe uroj që edhe ju ta lexoni bashkë me mua.

Sic e thashë edhe më parë, i afrohem librit të Zbulesës me frikë dhe dridhje, kryesisht jo për shkak të mungesës së aftësisë nga ana ime (edhe pse ajo mund të jetë shumë e dukshme), por në këtë ndjenjë hyjnë edhe shumë faktorë të tjerë. Së pari, mund të ekzitojë një mungesë njohurie nga ana e lexuesve. Libri i Zbulesës është libri i gjashtëdhjetë e gjashtë i Biblës dhe ai renditet i fundit. Kjo do të thotë se ne duhet të njohim gjashtëdhjetë e pesë librat e tjerë para se të arrijmë në këtë vend. Ju duhet të keni parasysh sfondin e njohurisë të të gjithë librave që vijnë para Zbulesës. Ju duhet të keni në mendjen tuaj atë cfarë thuhet në të gjithë Shkrimin si edhe faktet që jepen në të. Dua të them se ekziston edhe një faktor i dytë që më jep një ndjenjë alarmi ndërsa filloj studimin e këtij libri. Ky faktor është atmosfera bashkëkohore, kur ne po japim këto studime për Zbulesën. Jo për shkak të një epoke dyshuese dhe skeptike – edhe pse është e tillë – por për shkak të ditëve të errta, të vështira dhe të dëshpëruara, ku jetojmë.

Ne shohim dështimin e drejtuesve në cdo fushë – qeveri, politikë, shkencë, edukim, ushtri dhe argëtim. Si ka mundësi që edukatorët që nuk mund të kontrollojnë as godinën e tyre, të sigurojnë drejtues për botën? Bizneset sot menaxhohen nga tajkunë (tycoon, ang.), persona që janë të suksesshëm në biznesin e tyre dhe janë bërë të pasur e të fuqishëm. Zëri i aktorëve mund të dëgjohet në programet debatuese mediatike. Mjafton t'i dëgjosh ata për një kohë të shkurtër dhe ke për të kuptuar se ata nuk kanë asgjë për të thënë. Ata flasin shumë, por nuk thonë asgjë me vlerë. Asnjë nga këto grupe apo segmente të shoqërisë sonë nuk ka ndonjë zgjidhje për këtë situatë. Ata janë dështim në fushën e udhëheqsisë. Kudo mund të dallohet fare mirë një mungesë verbuese drejtuesish. Nuk ka asnjë që të na nxjerrë jashtë kësaj kënetë morali ose jashtë vështirësive Laokonike {Laocoön-i ishte prift i Apollos, perëndisë së diellit ose Poseidonit, perëndisë së detit në mitologjinë greke. Ai duke pasur frikën e një mashtrimi nga ana e grekëve, i paralajmëroi trojanët që të mos e pranonin dhuratën e kalit prej druri që kishin lënë grekët. Ndërkohë që trojanët po diskutonin se çfarë vendimi duhet të merrnin, Poseidoni dërgoi dy gjarpërinj tek Laokoni dhe dy bijtë e tij. Gjarpërinjtë u mbështollën në formë spirale rreth bijve të tij dhe Laokoni u përpoq t'i ndihmonte, por ata e mbërthyen edhe atë dhe i mbytën që të tre. Shën. i përkthyesit.} me të cilat jemi koklavitur sot. Ne jetojmë në një kohë shumë të vështirë. Në fakt, mendoj se kjo është koha më e keqe në historinë e botës.

Njerëz të mirëinformuar kanë thënë shumë gjëra interesante për këtë epokë. Ju lutem, vini re se nuk po citoj ndonjë predikues, por burra të shquar të botës në fusha të tjera të jetës.

Dr. Urei, nga universiteti i Cikagos, që punoi për bombën atomike, e filloi një artikull në revistën Koler, me këto fjalë: “Unë jam një njeri i frikësuar dhe dua t’ju fus frikën edhe ju.”

Dr. Xhon R. Mott u kthye nga një udhëtim rreth e rrotull botës dhe deklarata e tij ishte se kjo ishte epoka “më e rrezikshme që bota kishte njohur”. Ai ngriti pyetjen se për ku ishim drejtuar. Pastaj më tej shpalli: “Kur mendoj për tragjedinë njerëzore, sic e pashë dhe e ndjeva, për sakrifikimin e idealeve të krishtera, më krijohet përshtypja që Zoti po përgatit rrugën për ndonjë vepër të drejtëpërdrejtë dhe të pafund.”

Kancelari Robert M. Haçins, i universitetit të Cikagos, para disa vitesh shokoi shumë njerëz kur deklaroi se “përkushtimi i përpjekjeve tona edukuese ndaj fëmijëve të moshës 6-21 duket i kotë.” Ai shtoi:

“Bota mund të mos zgjatë aq shumë.” Ai shpalli se për këtë arsye ne duhet të fillojmë edukimin e të rriturve.

Uinston Curçill ka thënë: “Koha mund të jetë e shkurtër”.

Mr. Luce, pronari i revistës, Jeta, Koha dhe Fati, foli për një grup misionarësh që u kthyen në fushat e tyre pas luftës. Duke folur në San Francisko, ai tha se kur ishte i vogël, si bir i një misionari presbiterian në Kinë, bisedonte shpesh me të atin për ardhjen premileniale të Krishtit. Ai mendonte se të gjithë misionarët që besonin në atë mësim ishin të prirur të ishin fanatikë. Në fund ai tha: “Pyes veten, nëse ka vërtet dicka pas kësaj pikëpamje.”

Është shumë interesante kur vë re se në publikimin e “Shekullit të krishterë” gjendet një artikull nga Uesner Falloë që thotë: “Puna e të krishterit është që të bëjë përgatitje për fundin e botës.”

Dr. Carls Biërd, historiani amerikan ka thënë: “Në mbarë botën, mendimtarët dhe kërkuesit, që hetojnë horizontin e së ardhmes po përpiqen të cmojnë vlerat e qytetërimit dhe të spekulojnë për të ardhmen e tij.”

Dr. Uilliam Jogt, në librin “Rruga e Qytetërimit” shkroi: “Shkrimi i dorës mbi murin e pesë kontinenteve na tregon se Dita e Gjykimit është afër.”

Dr. Reimond B. Fosdik, presidenti i fondacionit Rokfeler tha: “Shumë veshë kanë dëgjuar hapat e fatkeqsisë. Koha është e shkurtër.”

H. G. Uells deklaroi para se të vdiste: “Kjo botë është në fund të litarit të saj. Fundi i gjithçkaje që ne e quajmë jetë është shumë afër.”

Gjenerali Dagllas MekArtur tha: “Ne na u dha shansi ynë i fundit.”

Ish-presidenti Aisenhauer tha: “Pa ripërtëritjen e moralit në mbarë botën, nuk ka shpresë për ne, dhe një ditë do të zhdukemi në pluhurin e një shpërthimi atomik.”

Dr. Nikolas Marej Batler, ish-president i universitetit Kolumbia tha: “Fundi nuk është shumë larg.”

E, për ta bërë situatën më të pashpresë, kisha moderne nuk ka zgjidhje për problemet e botës në kohën ku jetojmë. Pas Luftës së Dytë Botërore ndodhi një rritje fenomenale në anëtarësinë e kishës, por kjo zgjati vetëm disa vjet. Rritja shkoi nga 20% e popullsisë në vitin 1884 deri në 35% të popullsisë në vitin 1959. Kjo ishte pika kulmore e anëtarësisë së kishës protestante. Dhe kjo tregon mundësinë e një kisha në zjarr për Zotin. Në atë kohë, kisha ishte e pasur dhe filloi të ngrinte programe të jashtëzakonshme, por kohët e fundit kisha ka pësuar shumë humbje, dhe padyshim që ajo nuk po ndikon aspak në kulturën bashkëkohore të kohës sonë.

Në vitin 1958, i ndjeri David Lourens shkroi një kryeartikull të titulluar “Rrëmuja në botë”. Ai përshkroi gjithcka me shumë saktësi, por edhe ai vetë nuk kishte ndonjë zgjidhje për atë situatë. Ndërsa shohim botën në kohën ku jetojmë, mund të dallojmë se ajo ndodhet në mes të telasheve.

Shumë kohë më parë, njerëzit në pozitat e larta kanë parë të ardhmen dhe kanë thënë se po vjen një krizë e madhe. (Pyes veten se cfarë do të thoshin ata nëse jetonin në kohën tonë!) Si pasojë i këtij parashikimi është rritur interesi ndaj librit të Zbulesës.

Edhe pse studiuesit e mirë kanë mendime të ndryshme për detajet e librit të Zbulesës, kur bëhet fjalë për interpretimin e gjerë, ata kanë nxjerrë katër sisteme kryesore. (Brodus rendit shtatë teori interpretimi, ndërsa Trixhëlls tre të tilla).

1. *Interpretimi i kaluar* thotë se e gjithë Zbulesa është përmbushur në të shkuarën. Ajo i referohet kohës së Gjonit dhe ditëve të Nero-s, apo Domicianit. Kjo pikëpamje mbrohej nga Renan dhe shumica e studiuesve gjermanë, madje edhe nga Elioti. Qëllimi i librit të Zbulesës ishte që të ngushëllonte kishën e persektuar dhe u shkrua me simbole që të krishterët e asaj periudhe të mund t’i kuptonin.

Më lejoni të them se ky libër ka shërbyer për ngushëllimin e njerëzve të Zotit në të gjitha epokat, mbrojtja e pikëpamjes së *interpretimit të kaluar* do të thotë se edhe mund ta heqim librin e Zbulesës nga Bibla, pra që ai nuk ka asnjë farë kuptimi për kohën e tashme. Mendoj se kjo pikëpamje ka marrë përgjigjen e duhur dhe është dërguar në vendin e gjërave të humbura.

2. *Interpretimi historik* thotë se përmbushja e Zbulesës ndodh vazhdimisht në historinë e kishës, që nga koha e Gjonit deri në kohën tonë. Besoj, se në këtë pikëpamje ka një farë të vërtete, përse u përket shtatë kishave, sic do ta shohim, por përtej kësaj, është mëse e dukshme që libri i Zbulesës është libër profetik.

3. *Interpretimi historik-shpirtëror* është një përmirësim i teorisë historike dhe u zhvillua fillimisht nga Sër Uilliam Remsei. Kjo teori shpall se dy bishat janë Roma perandorike dhe Roma provinciale dhe se i gjithë qëllimi i këtij libri është të inkurajojë të krishterët. Sipas kësaj teorie, Zbulesa kryesisht është përmbushur dhe tani përmban vetëm mësim shpirtëror për kishën e sotme.

Pjesa më e madhe e sistemit amilenialist që njohim sot mbron këtë pikëpamje. Ajo përhapet shumë dhe humbet qëllimin e librit. Në shkollën teologjike të denominacionit tim, kam studiuar librin e Zbulesës si në greqisht, ashtu edhe në anglisht nga pikëpamja e

amilenialistëve. Ishte e habitshme kur shihje se si faktet e Zbulesës zhdukeshin në ajër vetëm me anë të një shprehje: “Epo, këto janë thjesht simbole.” Por, mësuesit atje nuk ishin asnjëherë në gjendje të na tregonin se çfarë simbolizonin. Ky ishte problemi i tyre më i madh. Cështja është se nga kjo pikëpamje lindin disa interpretime të pazakonta. Një interpretues e sheh Luterin dhe Reformimin si një simbol që për një student tjetër paraqet shpikjen e makinës së shtypit! Sipas meje, interpretime të këtij lloji e kanë dëmtuar dhe prishur qëllimin e librit të Zbulesës.

4. *Interpretimi i ardhshëm* është pikëpamja që mbrohet nga të gjithë premilenialistët, pikëpamje të cilën e pranoj edhe vetë dhe dua t’ju paraqes juve sot. Kjo lloj pikëpamje e sheh librin e Zbulesës kryesisht si profetik. Shumica e premilenialistëve ndjekin një lloj interpretimi që përputhet me Librin e Zbulesës. Ai fillon me zbulesën e Krishtit të lavdëruar. Pastaj, para nesh shfaqet kisha dhe e gjithë historia e saj. Në fund të kapitullit 3, kisha shkon në qiell dhe ne nuk e shohim më si një kishë, por si nusen, që do të vijë në tokë me Krishtin, kur Ai të kthehet për të themeluar mbretërinë e Tij – mbretërimi njëmijëvjeçar për të cilin do na flasë Gjoni. Ajo do të jetë një kohë prove, sepse në fund të asaj periudhe satani do të zgjidhet për një kohë të shkurtër. Pas kësaj, rebelimi përfundimtar rrëzohet dhe fillon përjetësia. Kjo është pikëpamja e Zbulesës që pranohet gjerësisht.

Në kohën tonë, disa kritikë të këtij interpretimi jo vetëm që thonë se ai nuk është i vërtetë, por deklarojnë edhe shumë gjëra të papëlqyeshme për të.

Postmilenialistët besonin se bota do të bëhej gjithnjë e më mirë, që kisha do të kthente në besim të gjithë botën dhe pastaj Krishti do të vinte për të mbretëruar. Kjo pikëpamje pothuajse ka vdekur sot. Pas dy luftrave botërore, krizës mbarëbotërore, dhe krizave nëpërmjet të cilave po kalon bota sot, ekzistojnë shumë pak njerëz që mbrojnë këtë pikëpamje. Në kohën kur u regjistrova në shkollën teologjike, cdo profesor ishte një amilenialist, kjo do të thotë se ata nuk besonin në mbretërimin njëmijëvjeçar të Krishtit. Pikërisht drejt kësaj pikëpamje u drejtuan të gjithë postmilenialistët për të gjetur strehë.

Duke marrë parasysh faktin, që mund të bëhem pak i mërzitshëm, dua t’ju jap pikëpamjet e disa njerëzve të së shkuarës për të treguar se ata po prisnin kthimin e Krishtit. Ata nuk po prisnin Mundimin e Madh, nuk po prisnin Mijëvjeçarin, por, ardhjen e Krishtit. Kjo pritje është zemra e pikëpamjes premilenialiste që ne mbrojmë sot.

Barnaba, që ishte një nga bashkëpunëtorët e apostullit Pal, është cituar se ka thënë këto fjalë: “Sabati i vërtetë është mijëvjecari kur Krishti do të vijë për të mbretëruar.”

Klementi (viti 96 pas Krishtit), peshkop i Romës, ka thënë: “Le të presim cdo orë mbretërinë e Perëndisë ... sepse nuk e dimë ditën.”

Polikarpi (viti 108 pas Krishtit), peshkop i Smirnës, i cili u dogj në turrën e druve ka thënë: “Ai do të na ringjallë nga të vdekurit ... ne do të mbretërojmë me Të.”

Ignatius, peshkopi i Antiokisë, për të cilin historiani Eusebius thotë se ishte pasuesi i apostullit Pjetër, komentoi: “Merrni parasysh kohët dhe priteni Atë.”

Papaja (viti 116 pas Krishtit), peshkopi i Hierapolis, i cili –sipas Irenaeusit- pa dhe dëgjoji apostullin Gjon, tha: “Mbretëria e Krishtit do të themelohet për njëmijë vjet në tokë.”

Justin Martyr (viti 150 pas Krishtit) tha: “unë dhe gjithë të tjerët që janë të krishterë ortodoks, në të gjitha pikat e dimë se në Jeruzalem do të ndodhë mijëvjecari ... ashtu si deklaroi Isaia dhe Ezekieli.”

Irenaeus (viti 175 pas Krishtit), peshkopi i Lions, duke komentuar premtimin e Jezusit për të pirë sërish nga fruti i hardhisë në mbretërinë e Atit të Tij thotë: “se kjo ... mund të përmbushet vetëm në kthimin personal të Zotit në tokë.”

Tertuliani, (viti 200 pas Krishtit) tha: “Në të vërtetë rrëfejmë se në tokë premtohet një mbretëri.”

Martin Luteri tha: “Le të mos mendojmë se ardhja e Krishtit është larg.”

Xhon Kalvin, në librin e tij të tretë të Instituteve shkroi: “Shkrimi në mënyrë të vazhdueshme na urdhëron të dëshirojmë me mall ardhjen e Krishtit.”

Kanon A. R. Fausset tha: “Etërit e hershëm të krishterë, Klementi, Ignatius, Xhastin Martir dhe Irenaeus, pritën ardhjen me shpejtësi të Zotit si një pararendës i nevojshëm i mbretërisë mijëvjecare. Por, kur kisha humbi dashurinë e saj të parë dhe u bë një prostitutë që mbështetej mbi fuqinë botërore, ajo ndaloi së qeni Nusja që do shkonte të takonte Dhëndrin dhe kërkoi të mbretëronte në tokë pa pritur mbërritjen e Krishtit.”

Dr. Eliot shkroi: “Të gjithë studiuesit primitivë, përveç Origenit dhe atyre pak njerëzve që mohonin Zbulesën, ishin premilenialistë.”

Vepra e Gaslerit mbi historinë e kishës flet për shpresën e lume që “ishte aq e dukshme dhe përmend se ne nuk hezitojmë ta konsiderojmë atë si besimin e përgjithshëm të asaj epoke.”

Çillinguorth deklaroi: “Kjo ishte doktrina që besohej dhe mësohej nga shumica e etërve të shquar të epokës që erdhi pas apostujve dhe kjo lloj doktrine nuk u dënua nga asnjë person i asaj epoke.”

Dr. Adolf von Harnak shkroi: “Etërit e hershëm – Irenaeus, Hipolitus, Tertuliani, etj – e besonin atë sepse ishte pjesë e traditës së kishës së hershme. E njëjta gjë ndodhi edhe në shekullin e tretë e të katërt me teologët latinë që i shpëtuan ndikimit të spekulimit grek.”

Të dashur miq, i citova të gjithë këta burra të së shkuarës si provë e faktit se që nga ditët e apostujve e deri në kohën e kishës së shekullit të parë, interpretimet e Shkrimit ishin premilenialiste. Nëse dikush deklaroi se premilenializmi është dicka që ka lindur rreth njëqind vjet më parë nga një shtrigë plakë në Angli, atëherë nuk di se për çfarë po flet. Është interesante të vësh re se premilenializmi ishte besimi i këtyre burrave të shquar të kishës së hershme.

Në librin e Zbulesës ekzistojnë gjashtë tipare të mahnitshme dhe të pazakonta.

1. Zbulesa është i vetmi libër profetik në Testamentin e Ri. Në Testamentin e Vjetër gjenden 17 libra profetikë, ndërsa në Testamentin e Ri vetëm një.

2. Gjoni, autori, i referohet përjetësisë së shkuar më shumë se cdo autor tjetër i Shkrimit. Ai e bën këtë në ungjillin e tij që hapet me këto fjalë: “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi.” (Gjon. 1:1). Pastaj, ai zhvendoset në kohën e krijimit: “Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij, dhe pa atë nuk u bë asgjë nga ato që u bënë.” (Gjon. 1:3). Më tej, kur Gjoni shkruan librin e Zbulesës, shkon në përjetësinë e ardhshme dhe mbretërinë mijëvjeçare të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezus Krisht.

3. Lexuesve të këtij libri u premtohet një bekim i vecantë: “Lum ai që lexon dhe lum ata që dëgjojnë fjalët e kësaj profecie dhe që ruajnë ato që janë shkruar në të, sepse koha është afër.” (Zbl. 1:3). Ky është një premtim i bekuar. Po, kështu në fund të këtij libri jepet një paralajmërim për të gjithë ata që përpiqen t’i fusin duart në përmbajtjen e tij: “Unë i deklaroj kujtdo që dëgjon fjalët e profecisë së këtij libri, se nëse ndokush do t’i shtojë këtyre gjërave, Perëndia do të dërgojë mbi të plagët e përshkruara në këtë libër. Dhe nëse dikush heq nga fjalët e librit të kësaj profecie, Perëndia do t’i heqë pjesën e tij nga libri i jetës nga qyteti i shenjtë, dhe nga gjërat që janë përshkruar në këtë libër.” (Zbl. 22:18-19).

Ky paralajmërim duhet t’i shtyjë ata interpretues të cuditshëm të profecisë të ndalojnë, të shikojnë dhe të dëgjojnë. Është e rrezikshme

të mos thuash asgjë që ka lidhje me Librin e Zbulesës, sepse sot ne njerëzit e kuptojmë se ndodhemi në një krizë të madhe në histori. Të thuash diçka që nuk përputhet me linjën e këtij libri do të thotë të mashtrosh njerëzit.

Këtu do ta mbyllim studimin tonë për sot. Më shumë mbi librin e zbulesës do të ndjekim në programin tonë të herës së ardhshme.